

UDHËZIM
Nr.1, datë 26.2.2007

PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË MARRA NGA GJOBAT, NGA ORGANI QË KA VERIFIKUAR SHKELJEN, NË ZBATIM TË LIGJIT NR.9573, DATË 3. 7.2006 “PËR AUTORIPARIMIN, SHITBLERJEN, DEPOZITIMIN E MJETEVE RRUGORE ME MOTOR, TË RIMORKIOVE DHE PJESËVE TË TYRE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT OSE TË BRAKTISURA DHE PËR VEPRIMTARITË QË LIDHEN ME TO”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 2 të nenit 41 të ligjit nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, Ministri i Financave, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

Neni 1

Të ardhurat nga gjobat, që merren nga verifikimi i shkeljeve, nga punonjësit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor ose të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në zbatim të këtij ligji, do të shpërndahen si më poshtë vijon:

1. 60 (gjashtëdhjetë) për qind e të ardhurave i kalojnë Buxhetit të Shtetit. Kalimi i të ardhurave në buxhet, bëhet sa herë që derdhen para në bankë nga organi që ka verifikuar shkeljen dhe ka vendosur gjobën.

2. 40 (dyzet) për qind e të ardhurave do t'i kalojnë organit që ka verifikuar shkeljen dhe ka vendosur gjobën.

Neni 2

1. Vleftha e të ardhurave nga gjobat, të destinuara për organin që ka verifikuar shkeljen, do të përdoret për shpenzimet e mëposhtme:

a) për blerjen e pajisjeve teknike të nevojshme për shërbimet, si dhe për funksionimin dhe mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve, në zbatim të këtij ligji;

b) për kryerjen e kurseve të kualifikimit dhe azhurnimit, ose të specializimit pasuniversitar të personelit, në lidhje me zbatimin e këtij ligji, si dhe për pjesëmarrjen e këtij personeli në kurset e mësipërme;

c) për operacione të ndryshme që kanë të bëjnë me investime, vrojtme, të nevojshme për kryerjen e të gjitha shërbimeve në kompetencë të këtij organi, për zbatimin e këtij ligji.

Neni 3

1. Përdorimi i të ardhurave të realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, do të bëhet në përputhje dhe duke respektuar limitin e përcaktuar në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit, për përdorimin e tyre.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE
PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Lulzim Basha

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi